

ABSTRAKT

Përkundër trendit të rritjes së numrit të personave të dënuar me burgim hulumtimet në lidhje me metodat e rehabilitimit që zbatohen në institucionet korrektuese të Kosovës janë të limituara. Ky punim diplome identifikon dhe analizon zbatimin e metodave për rehabilitimin e personave të dënuar në Qendrën Korrektuese të Dubravës, një prej institucioneve korrektuese më të mëdha në vendin tone. Metodologjia e hulumtimit përfshin analizimin e literaturës, intervista me stafin dhe drejtorin e qendrës, anketimin e të dënuarve si dhe observimin e aktiviteteve të tyre gjatë mbajtjes së dënimit. Gjetjet kanë zbuluar se në Qendrën Korrektuese në Dubravë janë të inkorporuara shumë prej metodave të rehabilitimit të rekomanduara nga aktet ndërkombëtare dhe literatura shkencore, përfshirë përkujdesjen shëndetësore, trajtimin psikologjik, arsimimin, aftësimin profesional, punësimin si dhe aktivitetet kulturore e sportive ndër të tjera, megjithatë zbatimi i tyre në praktikë has në sfida të konsiderueshme. Disa nga këto sfida përfshijnë mungesën e stafit dhe resurseve, mungesën e inovacionit në zbatimin e programeve, bashkëpunimin e kufizuar me sektorin privat, dhe numrin e pakët të shërbimeve të ndihmës post penale. Sfidat e identifikuara mund të adresohen përmes përmirësimit të praktikave, rritjes së numrit të kategorive të caktuara të punëtorëve, trajnimit të stafit aktual dhe zgjerimit të numrit të shërbimeve të ofruara pas lirimit. Aplikimi i këtyre rekomandimeve është në shërbim të arritjes së përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira dhe krijimit të strategjive më efektive të rehabilitimit dhe ri-integrimit të të dënuarve në shoqëri.